

Course Name : E Drejtë Civile I							
Course Code	Course Type	Regular Semester	Lecture (hours/week)	Seminar (hours/week)	Lab. (hours/week)	Credits	ECTS
LAW 225	N/A	Fall	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lecturer		Denard Veshi, Prof. Asoc. Dr.					
Assistant							
Course language		Albanian					
Course level		Program i Integruar					
Description		E drejta civile është një nga disiplinat e formimit karakterizues dhe profesional të programit të studimeve të nivelit të parë. Ky kurs ka për qëllim të familjarizojë studentët me strukturën bazë dhe përmbajtjen e të drejtës civile. Në këtë lëndë do të trajtohen parimet themelore të së drejtës private si dhe institutet bazë të së drejtës civile. Lënda fillon me kuptimin e të drejtës në përgjithësi e më pas përqëndrohet në trajtimin e pjesës së përgjithshme të Kodit Civil duke analizuar institutet e të drejtës civile si personat fizikë, personat juridike dhe llojet e tyre. Lënda do të ketë të integruar dhe diskutime dhe debate në klasë lidhur me temat specifike kontemporane të lidhura me të drejtën civile.					
Objectives							
Core Concepts		1. Marrëdhënia juridiko-civile 2. Subjektet e së drejtës 3. Personi fizik dhe juridik 4. Veprimi juridik 5. Pavlefshmëria juridike absolute 6. Pavlefshmëria juridike relative 7. Parashkrimi					
Course Outline							
Week	Topic						
1	Hyrje në të drejtë civile Njohuri të përgjithshme mbi të drejtën civile duke dhënë kuptimin, objektin dhe karakteristikat. Po ashtu, do të trajtohen parimet kryesore të së drejtës civile, burimet e saj si dhe lidhja me të drejtës civile dhe degëve të tjera të së drejtës. (Fq. 5-26)						
2	Traditat kryesore ligjore Ky leksion jep një panoramë të përgjithshme të traditave kryesore ligjore sic janë sistemi romano-gjermanik, sistemi anglo-sakson dhe sistemi kanonik dhe analizon kriteret mbi të cilat bëhen këto klasifikime. Gjithashtu analizon se cilës tradite i përket e drejta shqiptare. (Fq. 27-36)						
3	Veprimi i ligjit në kohë, hapësirë dhe ndaj personave Ky leksion bën një trajtim të mënyrës sesi ligji vepron në kohë, në hapësirë dhe ndaj personave. Gjatë këtij trajtimi jepen disa çështje të rëndësishme të së drejtës si fuqia prapavepruese e ligjit, zbatimi i ligjit shqiptar jashtë territorit shqiptar në kuadër të së drejtës ndërkombëtare private si dhe zbatimi i ligjit ndaj të huajve. (Fq. 37-49)						
4	Burimet e së drejtës dhe hierarkia e burimeve Në këtë temë jepet kuptimi i termit burim, cilësohen kategoritë e burimeve të vendosura në hierarki sipas Kushtetutës dhe trajtohet raporti i burimeve me njëra- tjetrën. (Fq. 50-61)						
5	Marrëdhëniet juridike Ky leksion jep përkufizimin e marrëdhënies juridike duke pasqyruar elementët e saj si objekti, subjekti dhe përmbajtja duke i trajtuar në mënyrë të detajuar secilën prej tyre. Gjithashtu jepet përkufizimi i faktit juridik, llojet e të drejtave, mbrotja e tyre nëpërmjet padive dhe llojet e padive. Një vëmendje e vecantë i kushtohet prapësimit dhe kundërpadsisë si mjete mbrojtjeje në duart e të paditurit. (Fq.75-104)						
6	Subjektet e së drejtës civile sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Në këtë leksion do të trajtohet personi fizik dhe juridik, zotësia juridike dhe zotësia juridike për të vepruar si dhe mbarimi, heqja dhe kufizimi i zotësisë për të vepruar. Gjithashtu, do të shpjegohet mënyra e shpalljes së zhdukjes dhe e vdekjes së një personi. (Fq. 107-122)						

7	Gjendja Civile Tema shqyrton banimin dhe rëndësinë e tij në të drejtën civile. Gjithashtu sqaron aktet e gjendjes civile, dallimin e tyre nga faktet që rregjistrohen në rregjistrin themeltar si dhe dallimin midis rregjistrave të gjendjes civile dhe atyre të akteve të gjendjes civile. (Fq. 123-135)
8	Mid term Exam
9	Personat Juridike Leksioni fokusohet tek nocioni dhe personaliteti juridik i personave juridike duke paraqitur disa teori mbi mënyrat e formimit të personave juridike ku mund të përmendet teoria organike, teoria e organizimit, teoria moderne etj. Pra, trajtohet doktrina shkencore lidhur me personat juridikë. (Fq. 136-148/ 177-190)
10	Personat Juridike Publikë dhe Private Leksioni bën një analizë të personave juridikë dhe llojeve të tyre duke përcaktuar momentin e fitimit të zotësisë juridike dhe zotësisë juridike për të vepruar. Bëhet klasifikimi i personave në persona juridikë publikë dhe privatë mbështetur në dispozitat e Kodit Civil. (Fq. 149-176)
11	Organizatat Jofitimprurëse Leksioni përqëndrohet në parimet dhe karakteristikat e përgjithshme të organizimit dhe të veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse si organizata që rregullohen me ligj të vecantë në vendin tonë. (Fq. 191-242)
12	Veprimet juridike dhe pavlefshmëria e tyre Kjo temë jep përkufizimin e veprimit juridik, përmbajtjen dhe elementët e tij. Gjithashtu trajtohen pavlefshmëria e veprimit juridik duke sqaruar llojet e pavlefshmërive të njohura si pavlefshmëri absolute dhe relative si dhe pasojat që sjellin tek personat e tretë. Veset e vullnetit si kanosja, dhuna fizike, mashtrimi, gabimi, simulimi dhe fiktiviteti. (Fq.271-312/ 324-352)
13	Elementët rastësore të veprimeve juridike Në këtë leksion do të trajtohet vecanërisht kushti dhe afati të vendosura në veprimet juridike, kuptimi i tyre si dhe dallimet që kanë nga njëri-tjetri. (Fq. 313-323)
14	Parashkrimi i padisë dhe dekadencia e të drejtave Kjo temë jep kuptimin e parashkrimit, kushtet, fushën e zbatimit dhe rëndësinë e tij. Gjithashtu trajtohet paditë e paparashkrueshme si dhe afatet e parashkrimit për paditë e parashkrueshme. Krahas kësaj mësohet llogaritja e afateve të parashkrimit, pezullimi dhe ndërprerja e parashkrimit. (Fq. 353-381)
15	Përsëritje
16	Final Exam
Prerequisites	
The student must attend the course at a minimum rate of 75%.	
Literature	
• Ardian Nuni, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme (Tiranë 2011) • Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë	
References	
• Ardian Nuni, Leksione të së drejtën civile (Tiranë 2004) • Ardian Nuni & Luan Hasneziri, Leksione të së drejtës së pronësisë (Tiranë 2006) • Nuni, Ardian. Hasneziri, Luan. Leksione të së drejtës së trashëgimisë, (Tiranw 2006) • Francesco Galgago, E drejta private (Tiranë: Biblioteka e Fakultetit te Drejtësisë 2001) • Avni Shehu, E drejta e Pronësisë (Biblioteka e Fakultetit te Drejtësisë)	
Course Outcome	
1	Studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth legjislacionit mbi të drejtën e pronësisë.
2	Njohja e instituteve më të rëndësishme të së drejtës civile.
3	Studentët do të mund të rrisin shprehitë dhe kapacitetet e nevojshme në shkrimin e materialeve teoriko- praktike, të tilla esse, artikuj, tema, e të tjera të ngjashme me to.
4	Studentët do të mund të pajisen me njohuritë bazë rreth instituteve të përfaqesimit, veprimeve juridike, parashkrimit, pronësisë dhe trashëgimisë, e cila jepet nëpërmjet interpretimit të hollësishëm të përmbajtjes së dispozitave të Kodit Civil.

Course Evaluation			
In-term Studies	Quantity	Percentage	
Midterms	1	30	
Quizzes	0	0	
Projects	0	0	
Term Projects	0	0	
Laboratory	0	0	
Class Participation	1	20	
Total in-term evaluation percent			50
Final exam percent			50
Total			100
ECTS Workload (Based on Student Workload)			
Activities	Quantity	Duration (hours)	Total (hours)
Course duration (Including the exam week: 16x Total hours of the course)	16	4	64
Study hours outside the classroom (Preparation, Practice, etc.)	14	6	84
Duties	0	0	0
Midterms	1	1	1
Final Exam	1	2	2
Other	0	0	0
Total Work Load			151
Total Work Load / 25 (hours)			6.04
ECTS			6.00